



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KE.nr. 1716/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson V.J avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Telekom i Kosovës Sh.a, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti borxh, vlera e kontestit 20,640.02 €, jashtë seancës, me datë 07.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve “S...”, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Telekom i Kosovës Sh. A që paditësit të ia paguaj shumën prej 20,640.02 €, në emër të borxhit si dhe kamatën e kontraktuar deri në pagesën definitive të borxhit, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore NË TËRËSI SI E PABAZUAR.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi “Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, përmes avokates V.J, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjen Ekonomike, me datën 09.11.2021 ka parashtruar padi për kthim të borxhit në shumën prej 20,640.02 €, me kamatë të kontraktuar, kundër të paditurës Telekom i Kosovës Sh.a.

E autorizuar e paditësit, me datën 01.11.2022, me anë të parashtrësës, e ka njoftuar Gjykatën se e paditura në procedurë jashtëgjyqësore ka shprehur vullnetin që ta paguaj obligimin që paditësi e kërkon përmes padisë dhe përmes kësaj parashtrëse bën tërheqjen e padisë dhe kërkesëpadisë.

Sipas nenit 149 par. 1 të LPK-së, përcaktohet se “ *Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë), ndërsa me par. 2 të këtij neni përcaktohet se “ Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur”.*

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së të autorizuarës së paditësit dhe meqenëse në rastin konkret bëhet fjalë për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, në kuptim të nenit 149 lidhur me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1716/22, datë 07.11.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.